



644
6-5-22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 644/Prot.

Lënda: Dërgim rezolute

Tiranë më 05.05 2022

ENTIT RREGULATOR TË ENERGJISË

T i r a n ë

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregulator të Energjisë për vitin 2021”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETA RE

Lindita NIKOLLA

KUVENDI

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR
TË ENERGJISË PËR VITIN 2021**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur Entin Rregulator të Energjisë si rregulatorin e vetëm dhe të pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke theksuar se situata e krizës globale energjetike ka çuar në një rritje të çmimit të energjisë në tregun ndërkombëtar në nivele si kurrë më parë, me pasoja të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit;

Duke vlerësuar trendin pozitiv të uljes së nivelit të humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes, i cili vijon të ketë një rënje nga viti në vit, për vitin 2021 ato arritën në nivelin 20.62%, duke shënuar një ulje të mëtejshme krahasuar me nivelin prej 21.48% të vitit 2020, ndërkohë niveli total i arkëtimeve për vitin 2021 arriti shifrat 97.4% krahasuar me 95.8% që ishte në vitin 2020, ky tregues në vitet e fundit është konsoliduar në nivelin mbi 95%;

Duke theksuar se, megjithëse me vonesë, u arrit përzgjedhja e Ofruesit të Shërbimit të operimit të bursës, një hap i rëndësishëm ky për funksionimin dhe futjen në operim të Bursës Shqiptare të energjisë elektrike ALPEX;

Duke theksuar se klientët buxhetorë dhe jobuxhetorë vazhdojnë të jenë problem për sa u takon pagesave të faturave të energjisë elektrike, duke akumuluar një borxh për shoqërinë FSHU sh.a. dhe duke krijuar vështirësi financiare për këtë të fundit,

Shqyrtoi veprimtarinë e ERE-s për vitin 2021 dhe vlerëson:

- Punën e bërë për ndarjen funksionale të OSHEE sh.a., si hap i rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në liberalizimin e tregut të energjisë elektrike dhe hapjen e mëtejshme të tij.

- ERE ka punuar për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me ZRRE-në (Rregullatori i Kosovës) për njohjen reciproke të licencave në veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit mes Shqipërisë dhe Kosovës, i cili i hap rrugën operimit të një tregu të përbashkët, si dhe ul kostot administrative dhe financiare të të licencuarve në të dyja vendet për të operuar në të dyja tregjet.

- Punën e bërë për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, zvogëlimin e afateve të trajtimit të ankesave, si dhe komunikimin dhe përpjekjet e vazhdueshme për të informuar konsumatorin për të drejtat dhe detyrimet ndaj operatorëve të licencuar, por edhe për të drejtat e tyre në raport me ERE-n.

- Punën për bërjen funksionale të Tregut të Balancimit të Energjisë Elektrike, e kërkuar dhe e mbështetur edhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë, si një hap i rëndësishëm në reformën e sektorit të energjisë në vendin tonë, veçanërisht për liberalizimin e tregut të energjisë.

- Punën e bërë për vlerësimin e kuadrit rregulator dhe ligor, përfshirë edhe tarifimin e shërbimeve që vijnë nga përdorimi i teknologjive të reja, siç është rasti i stacioneve të ngarkimit të automjeteve elektrike.

- Punën e bërë për informimin dhe sensibilizimin e konsumatorit përmes nënshkrimit të memorandumeve të bashkëpunimit me disa universitete, përgatitjes së broshurave informative për konsumatorin, publikimit të tyre në faqen zyrtare të ERE-s dhe rrjetet sociale, prezantimet pranë shoqatave të konsumatorit, si dhe vënien në funksion të një numrin telefonik të dedikuar për konsumatorin.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 rekomandon që ERE të angazhohet veçanërisht në këto aspekte të veprimtarisë së saj:

1. Në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe aktorët e tjera në fushën e energjisë të luajë një rol aktiv në hartimin e një plani konkret për të bërë të mundur lehtësimin e barrierave, promovimin, si dhe incentivimin e impianteve të vetëprodhimit të energjisë nga burime të rrinovueshme (veçanërisht nga dielli dhe era) si për bizneset e mëdha prodhuese, që kanë një konsum energjie më të lartë, ashtu edhe për familjarët. Investimi në impiante të vetëprodhimit të energjisë nga burime te rrinovueshme, duke pasur parasysh edhe situatën dhe zhvillimet më të fundit në tregun global të energjisë, ndikon nga njëra anë në uljen e shpenzimeve të energjisë për bizneset prodhuese dhe familjarët dhe nga ana tjetër në uljen e konsumit të energjisë nga rrjeti dhe diversifikimin e prodhimit të energjisë.

2. Duke pasur parasysh çmimet e larta të energjisë dhe zhvillimet më të fundit në tregun global të energjisë, në bashkëpunim me të gjithë aktorët në këtë fushë të japë kontributin e saj dhe ekspertizën teknike për të bërë të mundur forcimin e mekanizmave mbështetës për konsumatorët në nevojë, si dhe ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor.

3. Të vijojë intensivisht bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për hartimin sa më parë të metodologjisë së përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga vetëprodhuesit, si dhe të luajë një rol proaktiv dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët për zgjidhjen e problematikave të ndryshme që lindin nga instalimi i burimeve të vogla të rrinovueshme, si për shembull problemi i mënyrës së trajtimit të netimit nga ana e OSSH, etj.

4. Të kërkojë impenjim maksimal nga të gjithë aktorët për të bërë të mundur që brenda vitit 2022 operimi i bursës të jetë funksional. Funksionimi i bursës ka ndikim të drejtpërdrejtë në bashkimin e tregut të energjisë elektrike midis Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe në lehtësimin e bashkimit me tregje të tjera të vendeve fqinje në përputhje me rregulloret e tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe modelin e synuar europian.

5. Të vijojë mbështetjen me ekspertizën teknike për të bërë të mundur ndërtimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror si një projekt me rëndësi për vendin në drejtim të rritjes së prodhimit të energjisë dhe diversifikimit të burimeve të prodhimit, si dhe të bëjë propozime konkrete në funksion të mundësive të reja të krijuara për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tregut të gazit. Fillimi nga puna i gazzjellësit TAP duhet parë me prioritet nga ERE si një mundësi që e bën akoma më të domosdoshëm ndërtimin e këtij rrjeti për rritjen e prodhimit të energjisë përmes shfrytëzimit të gazit.

6. Në faqen zyrtare në internet duhet që linku/grafika “Bëj një ankesë” dhe numri i gjelbër në dispozicion të qytetarëve/konsumatorëve të jetë në faqen kryesore dhe lehtësish i aksesueshëm, mbrojtja e konsumatorit është një ndër objektivat kryesorë të ERE-s.

7. Gjatë vitit 2022 të miratojë dhe të fillojë zbatimin e Rregullores për Masat e të Licencuarve në Aktivitetin e Furnizimit për Arritjen e Treguesve të Matjes dhe Vlerësimit nga ERE të Performancës së Shërbimit ndaj klientit si një hap i rëndësishëm që ndikon në ofrimin e një shërbimi cilësor dhe me standarde për konsumatorin.

8. Të vijojë të ndjekë dhe monitoro jë me rigorozitet problematikat që kanë lidhje me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike, në mënyrë të veçantë zbatimin e detyrave që rrjedhin për FSHU sh.a. në përputhje me vendimin e Bordit të ERE-s “Mbi rishikimin e planit të masave për Operatorin e Shpërndarjes të Energjisë Elektrike “OSHEE sh.a.”, për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike”.

9. Në bashkëpunim me Agjencinë e Eficiencës dhe duke iu referuar edhe praktikave më të mira ndërkombëtare të punojë për sensibilizimin e konsumatorit për përdorimin eficient të energjisë elektrike, çka përkthehet në kursim energjie dhe më pak kosto për vetë konsumatorin.

10. Të marrë masat e nevojshme për realizimin dhe implementimin e platformës përmes së cilës të licencuarit në veprimtarinë e furnizimit, që do ta ushtrojnë këtë aktivitet për furnizimin e klientëve në treg të lirë, do t’iu mundësohet të hedhin të dhëna në kohë reale në lidhje me çmimin e ofruar për furnizimin me energji elektrike në treg të lirë.

11. Të vijojë të kërkojë mundësinë e instalimit gradual të matësve inteligjentë, bazuar në një analizë kosto-përfitim dhe të mbulimit me rrjetin e telekomunikacionit, pasi veç të tjerash përmirëson cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorit, duke evituar problematikat e mbifaturimit dhe ankesat e konsumatorëve. Faktet tregojnë se edhe gjatë vitit 2021 ankesat me objekt “mbifaturim të energjisë elektrike” janë rritur krasasuar me një vit më parë duke zënë vend kryesor në totalin e ankesave të regjistruara në ERE.

Miratuar në datën 28.4.2022